

Udhëzues mbi vlerësimin e rrezikut dhe  
hapat për mbrojtjen e fëmijët që  
rrezikohen nga trafikimi apo shfrytëzimi.  
Raportimi dhe regjistrimi i të dhënave.

mars 2021

## Pasqyra e Lëndës

<b>Përmbledhje .....</b>	<b>3</b>
<b>Hyrje.....</b>	<b>3</b>
<b>Informacione .....</b>	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>Objektivat .....</b>	<b>3</b>
<b>Puna e lejueshme e fëmijëve, puna e palejueshme e fëmijëve dhe trafikimi i fëmijëve .....</b>	<b>4</b>
<b>Intervistimi i fëmijëve .....</b>	<b>5</b>
<b>Vlerësimi i rrezikut dhe reagimi.....</b>	<b>8</b>
<b>Veprimet nëse evidentohen tregues të vulnerabilitetit të fëmijës.....</b>	<b>8</b>
Nivel i ulët rreziku.....	9
Nivel i mesëm rreziku .....	9
Nivel i lartë rreziku.....	9
Niveli i menjëhershëm i rrezikut.....	10
<b>Veprimet nëse evidentohen tregues të punës së palejueshme të fëmijës .....</b>	<b>11</b>
Të përgjithshme:.....	11
A po punon fëmija nën 18 vjeç? .....	11
Për fëmijët ndërmjet moshave 16 dhe 18 vjeç:.....	13
Për fëmijët ndërmjet 14 dhe 16 vjeç.....	13
<b>Veprimet nëse evidentohen tregues të punës së palejueshme të fëmijës .....</b>	<b>14</b>
<b>Raportimi dhe regjistrimi i të dhënave .....</b>	<b>15</b>
<b>Shtojca 1: Lista e kontrollit për evidentimin e punës së palejueshme të fëmijës .....</b>	<b>16</b>
<b>Dokumentacioni nga ana e punëdhënësit.....</b>	<b>16</b>
<b>Vëzhgimi i Vendit të Punës .....</b>	<b>16</b>
<b>Intervistimi i fëmijës .....</b>	<b>17</b>
Intervistimi i prindërve të fëmijëve që punojnë .....	17
Intervistimi i punëdhënësve.....	17
<b>Shtojca 2: Udhëzuesi për intervistimin e fëmijës.....</b>	<b>19</b>

## Përmbledhje

Ky udhëzues trajton vlerësimin dhe mbledhjen e të dhënave në lidhje me rrezikun e shfrytëzimit dhe trafikimit të fëmijëve, si dhe përcaktimin e veprimeve mbrojtëse për fëmijët, duke përfshirë rastet që duhen ndjekur penalisht.

Udhëzuesi hartuar me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, synon t'u vijë në ndihmë Punonjësve për Mbrojtjen e Fëmijës dhe strukturave tjera të mbrojtjes së fëmijës që të përmbushin përgjegjësitë e tyre në rastet e fëmijëve të shfrytëzuar dhe/ose trafikuar.

## Hyrje

Raporti i OSBE-së, Tipologjia e Rasteve të Trafikimit të Fëmijëve në Shqipëri<sup>1</sup>, i cili u prezantua më Korrik të vitit 2020, zbuloi se shumë prej ligjeve dhe politikave të Shqipërisë ofrojnë baza të forta për reagim të efektshëm ndaj trafikimit të fëmijëve, si pjesë e një kuadri më të gjerë të mbrojtjes së fëmijëve.

Sidoqoftë, raporti zbuloi gjithashtu se nuk po përmbushet potenciali i plotë i këtij kuadri për mbrojtjen e fëmijës, si pasojë e hendeqeve të zbatimit nga ana e aktorëve kyç për mbrojtjen e fëmijës.

Një nga mangësitë kryesore të sistemit të mbrojtjes së fëmijës ka të bëjë me grumbullimin e të dhënave për fëmijët në rrezik, duke përfshirë edhe masat për mbrojtjen e fëmijëve në situata shfrytëzimi, siç është edhe trafikimi. Duket se ka mospërputhje të madhe në lidhje me përjasjet e grumbullimit të të dhënave, vendimmarrjen dhe me mbajtjen e të dhënave, çka tregon një lloj mungese të familjarizimit me procesin e trafikimit dhe me procedurat dhe përgjegjësitë për mbrojtjen e fëmijës.

Studimi arriti përfundimin se mungesa e një baze të dhënash kombëtare të njëjësuar për mbrojtjen e fëmijës ka kontribuar tek mangësitë e sipërpërmendura.

Me qëllim trajtimin e këtyre mangësive OSBE po asiston në përgatitjen e një bazë e re kombëtare të dhënash për regjistrimin dhe gjurmimin e informacioneve për fëmijët dhe për të ndihmuar arritjen e mbrojtjes së përshtatshme, në përputhje me ligjet dhe politikat e Shqipërisë.

## Objektivat

Ky udhëzues ka për qëllim krijimin e përjasjes së njëjësuar për grumbullimin dhe regjistrimin e të dhënave për fëmijët e rrezikuar nga puna e palejueshme e fëmijëve dhe nga trafikimi i fëmijëve në Shqipëri, për t'u ardhur në ndihmë Punonjësve për Mbrojtjen e Fëmijës dhe aktorëve të tjerë të fushës për evidentimin e fëmijëve në situata shfrytëzimi, për hartimin e planeve të të mbrojtjes për fëmijët, për të mbikëqyrur rastet e tyre, dhe për t'u siguruar se të gjitha strukturat përkatëse, përfshirë edhe ata ligjzbatues, janë duke përmbushur detyrat e tyre ndaj fëmijës.

---

<sup>1</sup> Shihni - <https://www.osce.org/files/f/documents/9/9/457546.pdf>

## Puna e pranueshme e fëmijëve, puna e papranueshme e fëmijëve dhe trafikimi i fëmijëve

Me qëllim vlerësimin e përshtatshëm se nëse fëmija gjendet në rrezik të punës së papranueshme të fëmijëve apo të trafikimit të fëmijëve, pikësëpari është e rëndësishme të kuptohen këto terma.

Përkufizimet dhe dallimet ndërmjet punës së pranueshme të fëmijëve, punës së papranueshme të fëmijëve dhe trafikimit të fëmijëve përmbledhen në Figurën 1 më poshtë.

Gjatë mbledhjes së të dhënave nga fëmijët, Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijës dhe strukturat e tjera të fushës do të synojnë të dallojnë nëse fëmija gjendet në ndonjë prej këtyre kategorive dhe, nëse ndodhet në situatën e punës së papranueshme të fëmijëve apo në atë të trafikimit të fëmijëve, të përcaktojnë se çfarë masash duhen ndërmarrë.




Figura 1: Përmbledhja e punës së pranueshme të fëmijëve, punës së papranueshme të fëmijëve dhe trafikimit të fëmijëve

Në përgjithësi, puna e papranueshme e fëmijëve:

- i largon fëmijët nga shkolla;
- kërkon orare të zgjatura;
- është punë që në vetvete kërcënon mirëqenien fizike, emocionale apo mendore të fëmijës; dhe
- vendet e punës paraqesin rrezik të madh për shkaktimin e dëmeve ndaj fëmijës.

Treguesit vendimtarë të punës së papranueshme të fëmijëve apo të trafikimit të fëmijëve mund të mos jenë gjithmonë të dukshëm në pamje të parë. Pra, përtej të kuptuarit se çfarë përfaqëson punë të papranueshme të fëmijëve dhe trafikim të fëmijëve, është e rëndësishme

të mbliidhen dhe të analizohen të dhënat për fëmijët që mund të jenë të rrezikuar nga këto forma shfrytëzimi, në mënyrë që të mundësohet ndërhyrje e shpejtë në rast se është e qartë se po ndodh shfrytëzim.

## Intervistimi i fëmijëve

Një prej burimeve kryesore të informacionit në lidhje me rrezikun dhe abuzimet e përjetuara nga fëmijët janë vetë fëmijët. Prandaj, duhet treguar kujdes i posaçëm gjatë marrjes së tyre në pyetje. Shtojcat e këtij dokumenti përmbajnë udhëzues për marrjen në pyetje, të cilët parashtrojnë fushat kryesore të informacionit që duhet grumbulluar me qëllim vlerësimin e përshtatshëm të vulnerabilitetit me të cilat përballen fëmijët, si dhe për të shqyrtuar nëse vulnerabiliteti në fjalë përbën rrezik për shfrytëzimin.

Siç theksohet tek shtojcat, udhëzuesit e marrjes në pyetje nuk janë pyetësorë. Ndërsa mund të jetë e nevojshme të merren të gjitha përgjigjet për pyetjet që përmbahen nga udhëzuesit e marrjes në pyetje, mund të mos jetë e nevojshme të drejtohen të gjitha pyetjet: përgjigjet e disa pyetjeve të caktuara mund të përmbajnë përgjigje për disa pyetje njëkohësisht. Pra, personat që drejtojnë pyetjet duhet ta përshtatin përjasjen e tyre sipas fëmijës që kanë përballë.

Organizata për mbrojtjen e fëmijëve ECPAT UK<sup>2</sup> parashtron disa parime thelbësore që drejtojnë marrjen në pyetje të fëmijëve.

- **Të orientuara drejt fëmijës** – jepuni fëmijës informacionet në mënyrë që ai/ajo t'i kuptojë. Pyeteni fëmijën se ku dëshiron të zhvillohet marrja në pyetje, në cilën orë, prej cilit/cilës dëshirojnë të merren në pyetje dhe cilin/cilën dëshirojnë të jetë i/e pranishëm. Sigurohuni që fëmija ta dijë se mund ta ndërpresë marrjen në pyetje në çdo moment, përpiquni të jeni të ndërgjegjshëm për humorin e fëmijës dhe ofrojini pushime të rregullta.
- **Pëlqimi i informuar dhe konfidencialiteti** –Sigurohuni se fëmija kupton plotësisht qëllimin e marrjes në pyetje dhe se për çfarë po japin pëlqim. Sigurohuni se ai/ajo e kupton se si do të përdoren informacionet e tij/saj, përfshirë edhe nëse do të hidhen në internet. Flitini fëmijës për konfidencialitetin dhe tregojini se emri apo informacionet evidentuese të tyre nuk do të përdoren.
- **Krijimtaria** – A ka mënyra të tjera për marrjen në pyetje përveç se të ulurit dhe të folurit? Shumë prej fëmijëve u pëlqen të lëvizin. A ka mënyra ndërvepruese dhe krijuese për grumbullimin e informacioneve, si për shembull përdorimi i artit apo i fjalëve, frazave dhe deklaratave të prera me gërshtë.
- **Një më një apo në grup** –Disa fëmijë mund të parapëlqejnë të flasnin në grup. A mund të ofrohet kjo si alternativë?

---

<sup>2</sup>Nga i intervista me Debbie Beadle, Shefja e Programeve, ECPAT UK

- **Ofroni pije freskuese** –Fëmija mund të mos ketë ngrënë apo pirë asgjë përpara intervistës. Sigurohuni që të ofrohen ushqime dhe pije, të cilat mund të merren nga fëmijët përpara nisjes së intervistës.
- **Mbrojtja dhe rreziku** –Duhet të siguroheni që fëmijët që do të merren në pyetje të mos dëmtohen në asnjë lloj forme nga procesi. Personat që do të drejtojnë pyetjet duhet të sigurohen të kryejnë një vlerësim të plotë për gjendjen emocionale, fizike dhe për mjedisin familjar të fëmijës.

Në kushte ideale, duhet të jetë i pranishëm edhe një i rritur i besuar për të diskutuar me fëmijën pas marrjes në pyetje. Nëse fëmija është i mërzitur apo nëse ka reagim emocional ndaj marrjes në pyetje, i rrituri i besuar mund të punojë me fëmijën. Një gjë e tillë mund të jetë e vështirë të organizohet gjatë vizitave të para të inspektimit, por duhet siguar në vijim të evidentimit dhe mbrojtjes, në bashkëpunim me strukturat dhe aktorët e tjerë shqiptarë për mbrojtjen e fëmijës.

Manuali i ONP-së për inspektorët e punës, *Luftimi i Punës së Fëmijëve*<sup>3</sup>, ofron udhëzime më të hollësishme për marrjen në pyetje të fëmijëve që punojnë, veçanërisht kur ata/ato gjenden në një vend pune:

*“Vizita e parë në një vend pune ku punojnë fëmijët ka gjasa të përmbajë fillimisht vëzhgimin e llojit të punës që kryhet, sigurinë dhe kushtet e shëndetit, orët e punës dhe pagesat, si dhe marrëdhënien e punësimit.*

*“Pasi t’ia kenë bërë me dije praninë e tyre drejtuesve apo përfaqësuesit të tij/saj [apo prindërve të fëmijës ose anëtarëve të tjerë të familjes që mbikëqyrin fëmijën] dhe të kenë treguar kredencialet, inspektorët do të kërkojnë të flasin me fëmijët në lidhje me punën e tyre, si dhe të grumbullojnë pikëpamjet e punonjësve të tjerë.”*

*“Gjatë marrjes në pyetje të fëmijëve që punojnë, është e rëndësishme të kihet parasysh që nuk është fëmija ai/ajo që po shkel ligjin; por [mund të jetë] punëdhënësi i fëmijës [apo prindi].*

*“Inspektori duhet ta shohë veten sikur është ai/ajo që po i kërkon nder fëmijës, dhe jo anasjelltas dhe, për këtë arsye, fëmija duhet parë si partner për shqyrtimin e situatës në fjalë. Në këtë mënyrë, fëmija mund të shohë përfitimin e marrjes në pyetje dhe jo të jetë inspektori ai/ajo që “kërkon” bashkëpunim, çka mund të frikësojë fëmijën që punon.*

*“Nëse fëmija bie dakord të merret në pyetje, atij/asaj i kërkohet të rrëfejë aspekte nga përvoja vetjake – si në mjedisin e punës, edhe jashtë tij. Duke qenë se inspektori kërkon ndihmën e fëmijës për të kuptuar situatën, personi që drejton pyetjet duhet të tregohet i/e ndjeshëm për*

<sup>3</sup>[https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/--ed\\_protect/---protrav/---safework/documents/instructionalmaterial/wcms\\_110148.pdf](https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/--ed_protect/---protrav/---safework/documents/instructionalmaterial/wcms_110148.pdf) - përdorur më 17 gusht 2019

*gjendjen emocionale të fëmijës, të jetë i/e ndërgjegjshëm për pasojat e marrjes në pyetje dhe duhet të respektojë të drejtën e fëmijës për të folur apo për të heshtur.*

*“Me qëllim marrjen e rezultateve të kënaqshme, personi që drejton pyetjet duhet gjithashtu të krijojë klimë të përshtatshme fizike dhe psikologjike. Klima fizike mund të mos jetë e përshtatshme kur aty pranë ka makineri që bëjnë zhurmë, kur njerëzit lëvizin përreth kur fëmija është i/e ulur në tokë dhe personi që drejton pyetjet qëndron në këmbë, e kështu me radhë. Prandaj, në kushte ideale, intervistimi duhet të kryhet larg syve dhe veshëve të eprorëve, apo edhe të bashkëmohatarëve nëse këta të fundit duken jomiqësorë. Por përparësitë e organizimit të marrjes në pyetje ndërsa fëmija po punon apo në mjedisin e punës duhen peshuar kundrejt mos përparësive dhe mundësisë për të bërë zgjedhje. Gjithashtu, duhet pasur parasysh se nëse fëmija largohet për kohë të gjatë nga vendi i punës, kjo mund të çojë në ndëshkime nga shefi, përveç rasteve kur qëllimi është që fëmija të largohet menjëherë nga vendi i punës.’*

*“Klima psikologjike përcaktohet nga fakti nëse kushtet janë të tilla për ta bërë fëmijën të ndihet rehat dhe i/e sigurt, apo dyshues dhe me ankth se mos qortohet, gjykohet, tallet dhe, për pasojë, viktimizohet nga shefi, apo denoncohet tek autoritetet. Fëmija mund të duket asnjans, pa ndjenja të qarta pozitive apo negative, apo edhe i/e larguar dhe jo i/e interesuar, apo miqësor/e dhe i/e ngrohtë, mirëpritës/e dhe i/e gatshëm për të folur, apo armiqësor/e dhe jobashkëpunues/e. Prandaj, personi që drejton pyetjet duhet të përpiqet të zgjedhë një moment të përshtatshëm gjatë pushimit apo drekës, duke pasur parasysh që koha larg punës ndikon tek rendimenti i fëmijës dhe mund t’i kushtojë atij/asaj para.*

*“Cilido qoftë reagimi i fëmijës, personi që drejton pyetjet duhet të përpiqet të krijojë atmosferë jokërcënuese, të ketë përjasje të ndjeshme dhe të kujdesshme dhe të nxisë fëmijën të flasë duke drejtuar pyetje të hapura. Mbi të gjitha, inspektorët duhet të dëgjojnë me vërtetësi se çfarë thotë fëmija, por duhet të dinë edhe kur të ndalojnë në rastet kur kujtimet dhe përvojat e fëmijës janë shumë të forta apo të dhimbshme.*

*“Pyetjet e mbyllura që thjeshtë kërkojnë përgjigje “po” ose “jo” janë ndonjëherë të nevojshme, por pyetjet e hapura janë më të mira pasi u lejojnë fëmijëve të përshkruajnë ose të shpjegojnë, të komentojnë ose të justifikojnë pikëpamje të caktuara. Nëse intervistuesi nuk arrin të marrë përgjigje për pyetjet e rëndësishme edhe pasi i riformulon ato, ndonjëherë është më mirë t’i kthehet më vonë asaj çështjeje. Është gjithashtu e rëndësishme të kuptohet se, si të gjitha marrjet në pyetje, fëmija mund të jetë duke i përshtatur përgjigjet me qëllim të kënaqë personin që drejton pyetjet, ose nga frika se rrëfimet mund të përdoren kundër atij/asaj. Prandaj, personi që drejton pyetjet duhet të jetë i/e ndjeshëm ndaj këtyre elementëve që nuk shihen apo që nuk shprehen.*

*“Pyetjet mund edhe të vërtetohen duke pyetur të njëjtën gjë në forma të ndryshme dhe në momente të ndryshme gjatë marrjes në pyetje. Për shembull, “A je i/e lumtur që punon këtu?” mund të pyetet disa herësi më poshtë:*

- *A mendon se mund ta bësh këtë punë për një kohë të gjatë? Pse mendon kështu?*
- *Si të trajtojnë këtu? A sillen mirë? Si e tregojnë mirësjelljen? A je i/e lumtur me mënyrën se si të trajtojnë?*
- *Më trego të lutem momentin më të lumtur që ke përjetuar këtu.*
- *Më trego ndonjë gjë të bukur që ke bërë këtu.”*

Është e rëndësishme që të shpjegojmë diçka për këtë udhëzues: duket sikur ai merr të mirëqenë, siç ndodh edhe me një pjesë të madhë të manualit për *Luftimin e Punës së Fëmijëve*, se puna e palejueshme e fëmijëve ndodh jashtë kontekstit të familjes. Në të vërtetë, **veçanërisht në bujqësi, puna e palejueshme e fëmijëve ka tendencën të ndodhë në kontekstin e familjes**. Prandaj, kur zhvillohen intervista me fëmijët në këtë kontekst është shumë e rëndësishme të kihet parasysh se “punëdhënësi” është gjithashtu prindi. Për këtë arsye, konteksti psikologjik i fëmijës është më i tensionuar, ku shfrytëzuesi potencial i fëmijës është në të njëjtën kohë dikush që fëmija e do shumë. Prandaj, inspektorët që zhvillojnë marrjet në pyetje në këto kontekste duhet të tregohen shumë të ndjeshëm ndaj këtyre çështjeve.

## Vlerësimi i rrezikut dhe reagimi

Nga të dhënat e mbledhura nga intervistimi i fëmijëve, vëzhgimi i vendit të punës dhe nga komunikimi me prindërit apo kujdestarët e fëmijëve, si dhe me njerëzit më të cilët ata/ato punojnë, sipas rastit, është e rëndësishme të kategorizohen dhe të vlerësohen të dhënat e grumbulluara.

Ja vlen të merren parasysh tre kategori të dhënash: ***Treguesit e vulnerabilitetit të fëmijës***; ***Treguesit e punës së palejueshme të fëmijës***; dhe ***Treguesit e trafikimit të fëmijëve***. Secila prej këtyre kategorive të të dhënave tregon nivelin e rrezikut për fëmijën dhe secili prej këtyre niveleve të rrezikut tregon reagimet e nevojshme mbrojtëse nga ana e autoriteteve.

Pjesët e mëposhtme përshkruajnë treguesit dhe veprimet që duhen ndërmarrë pas evidentimit të tyre.

### Veprimet nëse evidentohen ***tregues të vulnerabilitetit të fëmijës***

Ka katër nivele rreziku: i ulët; i mesëm; i lartë; dhe i menjëhershëm. Do të shpjegohet secili prej këtyre niveleve të rrezikut, së bashku me veprimet e nevojshme për t’u ndërmarrë në rast evidentimi. Këto nivele të rrezikut dalin prej asaj që UNODC-i e përshkruan si ***vulnerabilitet i fëmijës***. Ky vulnerabilitet mund të keqpërdoret për të arritur shfrytëzimin e fëmijës. Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC) vëren<sup>4</sup> se vulnerabiliteti mund të jetë “*personal, i lidhur me gjendjen, apo i lidhur me rrethanat*”.

Për shembull, **vulnerabiliteti personal** mund të ketë të bëjë me aftësinë e kufizuar fizike apo mendore të një individi. **Për arsye të moshës së tyre, të gjithë fëmijët duhen parë si “të personalisht vulnerabël.”**

<sup>4</sup>[https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/2012/UNODC\\_2012\\_Guidance\\_Note\\_-\\_Abuse\\_of\\_a\\_Position\\_of\\_Vulnerability\\_E.pdf](https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/2012/UNODC_2012_Guidance_Note_-_Abuse_of_a_Position_of_Vulnerability_E.pdf) - përdorur më 6 shkurt 2020



Fëmijët mund gjithashtu të ndodhen në **vulnerabilitet të lidhur me gjendjen** nëse, për shembull, ata ndodhen në mënyrë të parregullt në një vend të huaj, të ndarë nga prindërit dhe/ose janë të izoluar nga pikëpamja shoqërore apo gjuhësore.

Fëmijët mund gjithashtu të ndodhen në **vulnerabilitet të lidhur me rrethanat**, nëse janë të varfër, jashtë shkolle, apo të varur ndaj alkoolit ose drogës.

Siç thekson UNODC-i, këto rrethana vulnerabiliteti mund të kenë ekzistuar ose mund të jenë krijuar nga trafikuesi. Vulnerabiliteti i krijuar mund të kenë të bëjë (por jo vetëm) me izolimin shoqëror, kulturor, apo gjuhësor; gjendjen e parregullt dhe varësinë ndaj drogës.

#### Nivel i ulët rreziku

##### Nëse fëmija është

- Në kushte varfërie;

Kjo përbën **nivel të ulët rreziku** pasi fëmija ndodhet në situatë vulnerabiliteti që vendos në njëfarë **rreziku potencial** të shfrytëzimit. Kështu që:

- Rasti **mund** të shënohet për referim për shërbime dhe për mbikëqyrje në të ardhmen për të siguruar mirëqenien e fëmijës.

#### Nivel i mesëm rreziku

##### Nëse fëmija është

- Me aftësi të kufizuara mendore ose fizike; dhe/ose
- shtatzënë; dhe/ose
- nuk flet shqip

Secili prej këtyre treguesve paraqet **nivel të mesëm rreziku**, pasi fëmija ndodhet në situatë vulnerabël që e vendos në **rrezik potencial** të shfrytëzimit. Sa më shumë tregues të ketë, aq më i lartë është niveli i rrezikut.

Evidentimi i një treguesi të vetëm nënkupton që rasti kërkon:

- zhvillimin e menjëhershëm të një vlerësimi mbrojtës;
- Rasti duhet shënuar për mbikëqyrje në të ardhmen, për t'u siguruar për mirëqenien e fëmijës;
- Duhet të referohet tek një Punonjës i Mbrojtjes së Fëmijës që të menaxhojë rastin.

#### Nivel i lartë rreziku

##### Nëse fëmija

- Nuk lejohet të flasë për veten; dhe/ose
- Shfaq frikë apo është i/e tërhequr; dhe/ose
- Nuk e njeh mirë zonën; dhe/ose
- Duket se është neglizhuar apo se nuk ka kujdes, me rroba që nuk i bëjnë, të pista, me shëndet të keq apo i/e paushqyer; dhe/ose

- Shfaq sjellje të papërshtatshme për moshën, veçanërisht sjellje seksuale; dhe/ose
- Mban çanta/valixhe me qëllim udhëtimin, në mënyrë të pajustificuar

Secili prej këtyre treguesve paraqet **nivel të lartë rreziku**, pasi ndodhet në situatë vulnerabiliteti që e vendos në **rrezik potencial** të shfrytëzimit. Sa më shumë tregues të ketë, aq më i lartë është niveli i rrezikut dhe aq më e lartë mundësia që fëmija të jetë **viktimë** e shfrytëzimit apo abuzimit.

Evidentimi i një treguesi të vetëm nënkupton që rasti kërkon:

- zhvillimin e menjëhershëm të një vlerësimi mbrojtës për të vendosur për ndonjë masë të nevojshme mbrojtjeje.
- Rasti duhet shënuar për mbikëqyrje në të ardhmen, për t'u siguruar për mirëqenien e fëmijës.
- Duhet të referohet tek një Punonjës i Mbrojtjes së Fëmijës që të menaxhojë rastin.

#### Niveli i menjëhershëm i rrezikut

Nëse fëmija është

- ndarë nga prindi apo kujdestari ligjor; dhe/ose
- me status të parregullt emigracionin; dhe/ose
- i/e varur nga droga; dhe/ose
- Në një marrëdhënie seksuale të papërshtatshme, për shembull me një person shumë më të madh në moshë; dhe/ose
- Tregon shenja dhune fizike në trup; dhe/ose
- Kërcënohet me rituale fetare; dhe/ose
- Është i varur nga një i/e rritur të dënuar më parë, i/e cila nuk është prindi, për vepra që përfshijnë (por jo vetëm) trafikimin, krimet e lehta, apo veprat që lidhen me drogën; dhe/ose
- Duket se është nën kontrollin e një apo disa të rriturve, të cilët nuk janë prindërit apo kujdestarët ligjorë; dhe/ose
- Fëmija nuk është i miqësuar me të rriturit që e shoqërojnë; dhe/ose
- Ka dokumentacion të dyshimtë– për shembull ngjan si më i/e rritur seç thuhet në dokumente; dhe/ose
- Nuk është i/e regjistruar në gjendjen civile.

Këto përbëjnë **nivel të menjëhershëm rreziku**, pasi këto tregues tregojnë se fëmija është **viktimë e mundshme** e shfrytëzimit dhe që mund edhe të trafikohet. Sa më shumë tregues të ketë, aq më i lartë është niveli i rrezikut, pasi tregues të shumtë tregojnë gjasa më të larta që fëmija të jetë **viktimë** e shfrytëzimit apo abuzimit.

Evidentimi i një treguesi të vetëm nënkupton që rasti kërkon:

- zhvillimin e menjëhershëm të një vlerësimi të masës së mbrojtjes;
- Referimin tek një Punonjës i Mbrojtjes së Fëmijës me qëllim menaxhimin e rastit;
- Hartimin dhe zbatimin e Planit Individual të Mbrojtjes për fëmijën e identifikuar në nevojë për mbrojtje;
- Duhet caktuar një punonjës për mbrojtjen e fëmijës që të menaxhojë rastin;
- Duhet nisur hetim për rrezikun e trafikimit të fëmijës;
- Duhet të krijohet ndërlidhje zyrtare ndërmjet punonjësit të caktuar për mbrojtjen e fëmijës dhe strukturave përkatëse të policisë.

### Veprimet nëse evidentohen **tregues të punës së palejueshme të fëmijës**

Përveç vlerësimit të rrezikut në bazë të treguesve të vulnerabilitetit të fëmijës që përshkruhen më lart, mund të ketë edhe tregues më të drejtpërdrejtë të punës së palejueshme të fëmijëve në lidhje me rastet e posaçme. Prandaj, punonjësit për mbrojtjen e fëmijës dhe aktorët e tjerë që kanë përgjegjësi për mbrojtjen e fëmijëve duhet të marrin parasysh pyetjet e mëposhtme:

Të përgjithshme:

A është fëmija në rrezik

- Dëmtimi fizik
- Dëmtimi seksual
- Dëmtimi emocional
- Neglizhence
- Shfrytëzimi

Nëse ndodh ndonjëra prej pikave të mësipërme, atëherë kemi të bëjmë me **punë të palejueshme të fëmijës dhe** një gjë e tillë përbën **niveli të lartë rreziku** për punonjësit e mbrojtjes së fëmijës dhe kërkon

- Vlerësimi i nivelit të rrezikut
- Referimin tek një Punonjës i Mbrojtjes së Fëmijës me qëllim menaxhimin e rastit;
- Hartimin dhe zbatimin e Planit Individual të Mbrojtjes për fëmijën e identifikuar në nevojë për mbrojtje;

A po punon fëmija nën 18 vjeç?

A përfshin puna:

- punë nën tokë, nën ujë, në lartësi të rrezikshme, apo në hapësira të kufizuara.
- punë me makineri, pajisje dhe mjete të rrezikshme, apo punë që përmban mbajtjen apo transportimin manual të ngarkesave të mëdha.
- punë që mund t'i ekspozojë fëmijët ndaj substancave, agjentëve, apo proceseve dhe temperaturave të rrezikshme, apo ndaj niveleve të zhurmës apo dridhjeve që mund të dëmtojnë shëndetin e tyre.
- punë në kushte posaçërisht të vështira, si puna me orare të zgjatura gjatë natës.
- ngritjen dhe mbajtjen e peshave të renda
- punën në lartësi
- mirëmbajtjen e makinerive në lëvizje dhe pa mbrojtëse
- drejtimin e makinerive që nuk kanë mbrojtëse të plota.
- ekspozimin ndaj materialeve kimike shumë helmuese, helmuese dhe të dëmshme, duke përfshirë edhe materialet kancerogjene.
- ekspozimin ndaj asbestit
- ekspozimin ndaj rrezatimit jonizues të dëmshëm
- punën natën
- punën me agjentë biologjikë me rrezik të lartë
- drejtimin e vinçave, krikëve dhe ashensorëve që lëvizin me anë të makinerive
- punë që mund të çojë në kontakt me elektricitetin me voltazh të lartë, ku ekziston rreziku i zënies së korrentit
- punë në kushte jonnormale ngrohti, ftohti, dridhjes dhe zhurme—punë me makineri prerëse me korrent
- punë në thertore
- përzjerja dhe përdorimi i pesticideve dhe ekspozimi përgjatë spërkatjes ajrore – prodhimi, trajtimi dhe ruajtja e materialeve shpërthyesë dhe e artikujve që përmbajnë materiale shpërthyesë.
- punë që përfshin ekspozimin ndaj përbërjeve të plumbit në formë gazi, pluhuri, apo avulli, përfshirë edhe punën me bojëra me përmbajtje të madhe plumbi.
- Punë që përfshin prodhimin dhe trajtimin e metaleve të shkrira
- zhytjen për arsye tregtare dhe punën nën ujë
- peshkimin në det të thellë
- ngarkimin/shkarkimin e anijeve
- punë në miniera dhe nëntokë
- punë me makineri përpunuese të drurit që punojnë me korrent
- prerjen e pemëve dhe transportimin e tyre për përpunim të mëtejshëm
- punë me kafshë të egra, të rrezikshme dhe helmuese
- punë me shembjen e objekteve
- çmontimi i anijeve

Nëse ndodh ndonjëra prej pikave të mësipërme, atëherë kemi të bëjmë me **punë të palejueshme të fëmijës dhe** një gjë e tillë përbën **nivel të menjëhershëm rreziku** për punonjësit e mbrojtjes së fëmijës dhe kërkon:

- **Vlerësimi i nivelit të rrezikut**
- Marrjen e vendimit nëse fëmija duhet dërguar në një përkujdesje alternative (që mund të jetë - i afërm, institucion përkujdesi rezidencial, familje kujdestare)

- Hartimin dhe zbatimin e Planit Individual të Mbrojtjes për fëmijën e identifikuar në nevojë për mbrojtje;
- Duhet caktuar një punonjës për mbrojtjen e fëmijës që të menaxhojë rastin
- Duhet shqyrtuar posaçërisht nëse nevojitet hetim penal
- Nëse vlerësohet se nevojitet hetim penal, duhet krijuar ndërlidhje zyrtare ndërmjet punonjësit të caktuar për mbrojtjen e fëmijës dhe hetimit policor të trafikimit.

Për fëmijët ndërmjet moshave 16 dhe 18 vjeç:

Përtej të gjitha formave të punës që ndalohen shprehimisht për të gjithë fëmijët nën 18 vjeç, ka kufizime të posaçme për fëmijët ndërmjet moshave 16 dhe 18 vjeç. Pra, nëse një fëmijë që i përket kësaj grupmoshe NUK është i/e përfshirë në asnjë nga rolet e palejuara posaçërisht për fëmijët (që radhiten më lart), **por është i/e përfshirë në:**

- Punë mbi 6 orë në ditë
- Punë që nuk mund të gjykohet si “punë e lehtë” pa pajisje me autorizim nga Inspektorati i Punës
- Nuk ka marrë të paktën 4 javë pushime

Atëherë kemi të bëjmë me **punë të palejueshme të fëmijës dhe** një gjë e tillë përbën **nivel të lartë rreziku** për punonjësit e mbrojtjes së fëmijës dhe kërkon

- **Vlerësimi i nivelit të rrezikut**
- Hartimin dhe zbatimin e Planit Individual të Mbrojtjes për fëmijën e identifikuar në nevojë për mbrojtje;
- Duhet caktuar një punonjës për mbrojtjen e fëmijës që të menaxhojë rastin
- **Duhet shqyrtuar posaçërisht nëse nevojitet hetim penal**
- Nëse vlerësohet se nevojitet hetim penal, duhet krijuar ndërlidhje zyrtare ndërmjet punonjësit të caktuar për mbrojtjen e fëmijës dhe hetimit policor të trafikimit.

Për fëmijët ndërmjet 14 dhe 16 vjeç

Përtej të gjitha formave të punës që ndalohen shprehimisht për të gjithë fëmijët nën 18 vjeç, ka kufizime të posaçme për fëmijët ndërmjet moshave 14 dhe 16 vjeç. Pra, nëse një fëmijë që i përket kësaj grupmoshe NUK është i/e përfshirë në asnjë nga rolet e palejuara posaçërisht për fëmijët (që radhiten më lart), **por është i/e përfshirë në**

- Punë mbi 6 orë në ditë
- **Punë jashtë pushimeve të shkollës**

- Punë që nuk mund të gjykohej si “punë e lehtë” pa pajisje me autorizim nga Inspektorati i Punës
- Nuk ka marrë të paktën 4 javë pushime

Atëherë kemi të bëjmë me **punë të palejueshme të fëmijës dhe** një gjë e tillë përbën **nivel të lartë rreziku** për punonjësit e mbrojtjes së fëmijës dhe kërkon

- zhvillimin e menjëhershëm të një vlerësimi mbrojtës
- Hartimin dhe zbatimin e Planit Individual të Mbrojtjes për fëmijën e identifikuar në nevojë për mbrojtje;
- Duhet caktuar një punonjës për mbrojtjen e fëmijës që të menaxhojë rastin
- **Duhet shqyrtuar posaçërisht nëse nevojitet të njoftohen strukturat e policisë.**

Veprimet nëse evidentohen **tregues të punës së palejueshme të fëmijës**

Nëse një fëmijë evidentohet në gjendje të punës së palejueshme të fëmijëve (nga treguesit më lart) DHE

- Nën kontrollin e dikujt që nuk është prindi apo kujdestari ligjor, apo
- Nëse një pale të tretë i lejohet nga prindërit apo nga kujdestari që të shfrytëzojë fëmijën

Atëherë, ky është rast **trafikimi i fëmijës** dhe përbën **nivel të menjëhershëm rreziku** për punonjësit e mbrojtjes së fëmijës dhe kërkon

- zhvillimin e menjëhershëm të një vlerësimi dhe vendosjen më **mbrojtje emergjente**
- Hartimin dhe zbatimin e Planit Individual të Mbrojtjes për fëmijën e marrë në mbrojtje;
- Duhet caktuar një punonjës për mbrojtjen e fëmijës që të menaxhojë rastin
- **Duhet nisur hetim për rrezikun e trafikimit të fëmijës**
- Komunikohet menjëherë me strukturën përkatëse të policisë.

**Gjithashtu**, nëse fëmija është i/e përfshirë në:

- Prostitucion dhe pornografi me fëmijë
- Veprimtari të jashtëligjshme si vjedhje, lypje, apo prodhim dhe trafik droge
- Punë të detyruar prej borxhit

Atëherë, ky është rast **trafikimi i fëmijës** dhe përbën **nivel të menjëhershëm rreziku** për punonjësit e mbrojtjes së fëmijës dhe kërkon:

- Vendosjen në mbrojtje emergjente
- Hartimin dhe zbatimin e Planit Individual të Mbrojtjes për fëmijën e marrë në mbrojtje;
- Duhet caktuar një punonjës për mbrojtjen e fëmijës që të menaxhojë rastin;
- **Komunikohet në mënyrë urgjente me strukturat e policisë.**

## Raportimi dhe regjistrimi i të dhënave

Të dhënat e grumbulluara nga intervistimi që përshkruhet në këtë udhëzues, analizimi i këtyre të dhënave kundrejt treguesve të vulnerabilitetit, puna e palejueshme e fëmijëve dhe trafikimi i fëmijëve që përshkruhen më lart, si dhe veprimet vijuese, të cilat përfshijnë punonjësit përgjegjës për mbrojtjen e fëmijës dhe hetuesit policor që trajtojnë çështjen, duhet të regjistrohen në bazën kombëtare të të dhënave, të zhvilluar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.

## Shtojca 1: Lista e kontrollit për evidentimin e punës së palejueshme të fëmijës

Lista e mëposhtme e kontrollit ka për qëllim të ndihmojë inspektorët e punës që të vlerësojnë posaçërisht nëse një punë që po kryhet nga fëmijë është e lejueshme apo përbën punë të palejueshme të fëmijës. Lista mund të përdoret si për bizneset familjare, si për shembull ferma, edhe për bizneset ku fëmija është i/e punësuar nga persona të ndryshëm nga prindërit apo kujdestari.

### Dokumentacioni nga ana e punëdhënësit

1. A janë dokumentuar të gjithë punonjësit nga ana e punëdhënësit?
  - A zotëron punëdhënësi të dhëna që përmbajnë emrin, adresën dhe emrin e të afërmeve të punonjësit?
  - A zotëron punëdhënësi të dhëna për ditëlindjen e punonjësit?
  - A zotëron punëdhënësi të dhëna për kualifikimin përkatës të punonjësit?
  - A zotëron punëdhënësi të dhëna për rrogën e punonjësit?
2. A janë fëmijët të regjistruar si punonjës në atë vend pune?
  - A ka punëdhënësi politikë për menaxhimin e punonjësve fëmijë?
  - Cilat janë moshat e regjistruara të punonjësve fëmijë?
  - A ka autorizim të përshtatshëm nga Inspektorati i Punës?
  - Në çfarë orësh punojnë?
  - Cilat janë detyrat e tyre?
  - A është ndonjëra prej detyrave pjesë e kategorisë së një forme të keqe të punës së fëmijëve?

### Vëzhgimi i Vendit të Punës

3. Cilat janë përshtypjet e para që ju vijnë përvendin e punës?
  - A ka ndonjë rrezik fizik të dukshëm për punonjësit?
  - A janë ulur në ndonjë lloj forme këto rreziqe?
4. Si mbrohen fëmijët punonjës nga rreziqet fizike në vendin e punës, apo nga puna e papërshtatshme për moshën e tyre?
5. Si ndërveprojnë drejtuesit me punonjësit?
  - A ju duket se ky ndërveprim zhvillohet me respektin e përshtatshëm?
  - A perceptoni se ka tregues për ngacmimin seksual?
6. Si ndërveprojnë punonjësit me njëri tjetrin?
  - A perceptoni se ka bulizëm?
  - A perceptoni se ka tregues për sjellje të papërshtatshme seksuale?
7. Si sillen të rriturit me fëmijët punonjës?
  - A perceptoni se ka bulizëm?
  - A perceptoni se ka tregues për sjellje të papërshtatshme seksuale ndaj fëmijëve në vendin e punës?



## Intervistimi i fëmijës

Shih Shtojcën 2.

(Shënim: Referojuni edhe pjesës lart së këtij udhëzuesi për marrjen në pyetje të fëmijëve.)

(Shënim: Nëse fëmija ndahet nga prindi dhe kryen punë të palejueshme për fëmijët, ai/ajo mund të jetë viktimë e skllavërimit të fëmijëve, jo thjesht e punës së palejueshme të fëmijës?)

## Intervistimi i prindërve të fëmijëve që punojnë

8. Cilat janë burimet kryesore të të ardhurave në familjen tuaj?
9. Nga sa anëtarë përbëhet familja?
10. A mund të na thoni se sa anëtarë të familjes punojnë?
  - Çfarë punësh bën secili prej tyre?
  - Sa fiton secili?
  - Çfarë shpenzimesh ka secili?
  - A ndodh shpesh të keni mungesa parash?
11. Kush i merr zakonisht vendimet financiare në familje?
  - A është vendimmarrja e ndarë, kolektive, e ndryshme?
  - Si përdoren paratë?
  - Kush është përgjegjës për blerjen e produkteve ditore të nevojshme?
12. A ju ka ndodhur ndonjëherë që juve apo një anëtar të familjes suaj t'u jetë kërkuar të punoni pa pagesë për të shlyer një borxh?
13. A punon ndonjëri prej anëtarëve të familjes larg nga vendi ku banon me qëllim për të dhënë një dorë me financat e familjes?
14. Si ndiheni për fëmijët që punojnë?
15. Sipas mendimit tuaj, cilat lloj punësh janë të lejueshme dhe cilat jo?
16. A u duhet fëmijëve të bëjnë punë të ndryshme shtëpie?
  - Nëse po, çfarë punësh shtëpie? Sa zgjasin këto punë?
  - A janë detyrat e ndara sipas gjinisë?

## Intervistimi i punëdhënësve

17. A punojnë fëmijë (persona nën moshën 18 vjeç) këtu? Nëse po,
  - Cilët janë dhe çfarë moshe kanë?
  - A më tregoni më shumë për ta?
18. Si caktohen rrogat për fëmijët dhe sa shpesh paguhen dhe kush e merr pagesën e tyre?
19. Cilat janë përgjegjësitë kryesore të fëmijëve që punojnë këtu?
20. Cilat janë veprimtaritë fitimprurëse kryesore të familjes suaj?
21. Nga sa anëtarë përbëhet familja?
22. A mund të na thoni se sa anëtarë të familjes punojnë?
  - Çfarë punësh bën secili prej tyre?
  - Sa fiton secili?
  - Çfarë shpenzimesh ka secili?
  - A ndodh shpesh të keni mungesa parash?
23. Kush i merr zakonisht vendimet financiare në familje?
  - A është vendimmarrja e ndarë, kolektive, e ndryshme?
  - Si përdoren paratë?
  - Kush është përgjegjës për blerjen e produkteve ditore të nevojshme?

24. A ju ka ndodhur ndonjëherë që juve apo një anëtar të familjes suaj t'u jetë kërkuar të punoni pa pagesë për të shlyer një borxh?
25. A punon ndonjëri prej anëtarëve të familjes larg nga vendi ku banon me qëllim për të dhënë një dorë me financat e familjes?
26. Si ndiheni për fëmijët që punojnë?
27. Sipas mendimit tuaj, cilat lloj punësh janë të lejueshme dhe cilat jo?
28. A u duhet fëmijëve të bëjnë punë të ndryshme shtëpie?
  - A janë detyrat e ndara sipas gjinisë?
29. A ka pasur ndonjë rast kur një i rritur apo një fëmijë ka punuar këtu për të shlyer një borxh? (Shënim: puna e detyruar prej borxhit është tregues fundor i skllavërisë.)
30. Si ndiheni për fëmijët që punojnë?
31. Sipas mendimit tuaj, cilat lloj punësh janë të lejueshme për fëmijët dhe cilat jo?

## Shtojca 2: Udhëzuesi për intervistimin e fëmijës

Këto pyetje janë hartuar për të plotësuar vëzhgime të bëra nga Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijës dhe nga aktorët e tjerë, shqyrtimet e dokumenteve, dhe marrjet në pyetje të të rriturve, për të nxjerrë informacione nga fëmijët me qëllim vlerësimin nëse ata/ato po shfrytëzohen qoftë me anë të punës së palejueshme të fëmijëve, qoftë nga trafikimi i fëmijëve.

**Ky është udhëzues, nuk është pyetësor.** Ky material tregon informacionet që duhen synuar, por pyetjet dhe rendi i pyetjeve mund të përshtaten sipas situatës. Pra, intervistimi do të jetë gjysmë i strukturuar: që do të thotë se personi që drejton pyetjet mund të dojë të drejtojë variante të ndryshme të këtyre pyetjeve, ose pyetje shtesë të nxitura nga përgjigjet e marra. Në çdo rast, mos harroni se qëllimin i marrjes në pyetje është të përcaktoni nëse puna që po bëjnë fëmijët është e lejueshme apo është punë e palejueshme e fëmijëve.

I duhet kushtuar vëmendje nevojave të fëmijëve për mbështetje të vazhdueshme. Përgjatë marrjes në pyetje, personi që drejton pyetjet duhet të përqipet të vlerësojë nëse fëmija po i nënshtrohet kushteve apo praktikave shfrytëzuese të punës dhe nëse fëmija është trafikuar, siç përshkruhet më lart.

1. Hyrja
  - a. Mirëserdhe
  - b. Si quhesh?
  - c. A më thua datën e lindjes?
  - d. Si quhen prindërit/kujdestari yt?
  - e. Ku banon?
  - f. Gjithmonë atje ke banuar? (Nëse jo, pyeteni se ku ka banuar më parë dhe sa kohë ka që jeton në adresën aktuale.)
2. Arsimi
  - a. Ku e bën shkollën?
  - b. Sa kohë ke në atë shkollë?
  - c. Ke qenë në ndonjë shkollë tjetër më parë? Si e kishte emrin shkolla tjetër/Ku ndodhet?
3. Familja
  - a. Ku banon?
  - b. Banon me prindërit? (Nëse jo, me kë banon?)
  - c. A ke vëllezër ose motra?
  - d. Çfarë moshe kanë?
  - e. Çfarë punë bëjnë prindërit?/Çfarë pune bën i rrituri me të cilin jeton?
4. Puna
  - a. Ti, vëllezërit dhe motrat, a i ndihmoni ndonjëherë prindërit në punë?/ A e ndihmon në punë të rriturin me të cilin jeton?
  - b. A ma përshkruan se si i ndihmon?
  - c. A i ndihmon çdo ditë? Sa zgjat ndihma që u jep?
  - d. A punon me ndokënd tjetër?
  - e. Si e gjete atë punë?

- f. A ma përshkruan pak punën që bën të lutem?
- g. Sa orë punon në ditë tek ajo puna? A ka pushime gjatë ditës?
- h. A të pengon ndonjëherë me detyrat e shkollës?
- i. A mendon se puna që bën është e rrezikshme?
- j. A je lënduar ndonjëherë në punë? (nëse po: Si ndodhi?)
- k. A ke parë ndokënd të vritet në punë?
- l. A të duhet ndonjëherë të mbash pesha të rënda?
- m. A të duhet ndonjëherë të punosh nën tokë?
- n. A të duhet ndonjëherë të punosh nën ujë?
- o. A të duhet ndonjëherë të përdorësh makineri?
- p. A të duhet ndonjëherë të përdorësh elemente kimike?
- q. A të pëlqen puna që bën?
- r. Pse të pëlqen? / Pse nuk të pëlqen?
- s. Çfarë rrobash vesh zakonisht kur je në punë?
- t. Çfarë është gjëja më e parhatshme që bën në punë?
- u. Sa paguhesh? Sa shpesh paguhesh?
- v. Kush të thotë se çfarë duhet të bësh?
- w. Nëse do dëshiroje ta lije punën që bën këtu, a do mundje?

#### 5. Trajtimi në punë

- a. Si është shefi yt? A të trajton mirë?
- b. Si janë njerëzit me të cilët punon? A sillen mirë me ty? A ke ndonjë shok në punë? Çfarë mendojnë ata për punën që bëjnë?
- c. A të mërzit apo të sulmon ndokush kur je në punë?
- d. A ke pasur probleme me punën? Çfarë gjërash nuk të pëlqejnë në lidhje me të?
- e. A ka ndonjë veprimtari apo kusht në punën tënde për të cilën nuk ke rënë dakord?
- f. A ke ndokënd kujt mund t'i kërkosh ndihmë në punë nëse përballesh me vështirësi?
- g. A të ka bërë titur apo ulëritur ndonjëri në punë?
- h. A të ka lënduar ndonjëherë njeri në punë, duke të shtyrë apo gjuajtur për shembull?
- i. A të ka prekur ndonjëherë ndokush në mënyrë të papërshtatshme në punë?
- j. A të lejon puna kohë të mjaftueshme për detyrat e shkollës?
- k. A të lejon puna kohë të mjaftueshme për tu takuar me shokët/shoqet?

#### 6. Falënderimi dhe mbyllja

- a. Kaq pyetje kisha. Ka ndonjë gjë tjetër që dëshiron të thuash?
- b. Faleminderit shumë.